



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj:29597/2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Lulzim Pllana – Keshilltar politik ne Ministrine e Arsimit Shkences dhe Teknologjise, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, e në bazë të nenit 73, 74 dhe nenit 198 al.1 pika 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 27.09.2010 merr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurit Lulzim Pllana – Keshilltar politik ne Ministrine e Arsimit Shkences dhe Teknologjise, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë.

Procedura **pezullohet** konform nenit 198 al.1 pika 10 të Ligjit Mbi Kundervajtjet, pasi që parashtruesi ka hequr dore nga kërkesa .

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjensia Kunder Korrupsionit, parashtroi kërkesën me nr. 01/3265/10 të dt. 29.09.2010 për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër pandehurit te cekur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pasi qe Agjensia Kunder Korrupsionit permes shkreses se dates 11.10.2010 e ka tërhequr kerkesen per iniciimin e procedures kundervajttese ,gjykata konform nenit 198 al.1 pika 10 te LMK,se e ka Pezulluar proceduren kundervajttese duke vendosur si ne diapozitiv te këtij aktvendimi.

Me sa u cek me larte u vendos si ne diapozitiv te këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtrojë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës në afatin prej 8 ditësh, pas marrjes se këtij aktvendimi. Ankesa i parashtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

G j y q t a r j a
Zajrete Muhaxheri

